



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.354/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “NAKI Trade” SH.P.K., me seli në rr.“Agim Ramadani” nr.22/65, Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1418/2023 të datës 27.10.2023, me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1418/2023 i datës 27.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1418/2023 të datës 27.10.2023, ka aprovuar prapësimin e debitorit “NAKI Trade” SH.P.K., ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.96/2023 të datës 31.05.2023 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isak Islami dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa, ashtu që aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Në përgjigjen në ankesë, debitori deklaroi se kreditori nuk ka arrit që të konstatoj se cilat shkelje të procedurës përmbarimore janë bërë, dhe i propozon Dhomës së shkallës së dytë, që ta vërtetoj aktvendimin e atakuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, në kuptim të

nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, me datë 31.05.2023 ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit “NAKI Trade” SH.P.K., me seli në rr.“Agim Ramadani” nr.22/65, Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr.2023/01733 të datës 01.05.2023, në shumën e përgjithshme prej 5,896.34 Euro.

Përmbartuesi privat Isak Islami, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.96/2023 të datës 31.05.2023, ka lejuar përmbartimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 16.06.2023 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se fatura kthyese dhe kartela financiare në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet sipas nenit 29 dhe nenit 37 të LPP-së. Tutje ka theksuar se nga fatura nuk mund të vërtetohet se për cilën periudhë kohore është kërkuar borxhi, për cilat shërbime është lëshuar e njëjta, sepse në faturë është përshkruar vlera e faturës pas tatimit mbi qiranë 9 %, për një muaj në shumë prej 460.60 Euro, ndërsa borxhi total i kërkuar sipas faturës është 31,376.30 Euro, andaj si e tillë kjo faturë nuk mund të shërbejë si dokumenti i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Ndërsa sa i përket kartelës financiare ka deklaruar se e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në dispozitat e nenit 29 të LPP-së, nuk është përcaktuar si dokument i besueshëm. Andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 16.06.2023, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara me arsyetimin se ka vepruar komform rregullave ligjore me rastin e paraqitjes së urdhrin përmbartimor duke i respektuar të gjitha procedurat dhe duke i bashkëngjitur faturën kthyese Nr.2023/01733 dhe kartelën financiare të datës 31.05.2023 si dokumente të besueshme të cilat e kanë fuqinë e titullit përmbartues. Andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pabazuar, ndërsa urdhri për caktimin e përmbartimit P.nr.96/23 i datës 31.05.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1418/2023 të datës 27.10.2023, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit “NAKI Trade” SH.P.K., ka anuluar

urdhri përmbartimor P.nr.96/2023 të datës 31.05.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkak se në rastin konkret Fatura nr.2023/01733 e datës 01.05.2023 dhe Kartela Financiare e datës 31.05.2023 në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Tutje gjykata ka arsyetuar se Fatura Nr. 2023/01733 e datës 01.05.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nga kjo faturë nuk mund të vërtetohet se për cilën periudhë kohore është kërkuar borxhi, për cilat shërbime është lëshuar e njëjta, sepse në faturë është përshkruar vlera e faturës pas tatimit mbi qiranë 9 %, për një muaj, në shumën prej 422.30 €, ndërsa borxhi total i kërkuar sipas faturës është në shumën prej 31,376.30 €, andaj shërbimi i përshkruar në këtë faturë nuk përputhet me borxhin total i cili kërkohet sipas të njëjtës. Andaj duke qenë se fatura nuk e përmban objektin e detyrimit siç përcaktohet sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se dokumentet e bashkëngjitura këtij propozimi përkatësisht Kartela Financiare e datës 31.05.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 të LPP-së, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 të LPK-së dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban tiparet e përmbartueshmërisë dhe si e tillë nuk mund të jetë e përshtatshme për përmbartim. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 3 të LPP, i cili përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se Dhomat e Shkallës së Parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përbarimore, respektivisht është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton se fatura nuk e përmban kohën e përmbushjes së detyrimit dhe shërbimin se për cilin është lëshuar. Në Propozimin për përbarim dt.31.05.2023 kreditori kërkon borxhin e detyrimit ndaj debitorit, shumën prej 5,896.34€, ndërsa fatura 2023/01733 dt.01.05.2023 e bashkangjitur si dokument i besueshëm, përmban borxhin total prej 31,376.30€. Prandaj kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përbarimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përbarimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përbarimi janë tiparet e përbarueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga neni 29 paragrafi 3 dhe 37 të LPP-së.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase kemi të bëjmë me dokumentacione të cilat nuk janë në përputhje mes veti, në aspektin e detyrimit të lartësisë borxhit, dhe si të tilla nuk mund të vërtetohet se janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e përbarimit nga neni 29 dhe 37 të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.354/2024 me datë 02.05.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha